

A K T - T H E M E L I M I

I SHOQERISE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR SH.P.K. "A 91" (Ortak i vetëm)

Në bazë të ligjit 7512 datë 10.8.1991 dhe Ligjit 7518 datë 19.11.1992, unë Dashnor Laze, biri i Hamitit, d.l.1961, banues në lagjen 4 Sarandë vendosa të themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve që vijojnë:

N E N I 1

Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "A 91" SH.P.K."Ortak i vetëm".

N E N I 2

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është:

- Veprimtari në fushën e ndertimeve dhe montimeve elektrike.
- Veprimtari tregëtimi të materialeve elektrike me pakicë e shumicë, në vend e import-eksport.

N E N I 3

Selia e shoqërisë ndodhet në Republikën e Shqipërisë, në qytetin e Sarandës në adresën: Lagja 4 pallati 36.

N E N I 4

Kohëzgjatja e shoqërisë është mbi 10 vjet.

N E N I 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është i fiksuar në 100.000 lekë, i ndatë në 100 kuota me nga 1000 lekë secila.

N E N I 6

Kuotat e shkëlqiuara nga ortaku në kapitalin themeltar janë të tërësisht transferueshme midis të gjalleve me akt noterial.

N E N I 7

Ortaku i vetëm mund të vendose për zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar të shoqërisë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kapitali themeltar është i depozituar në Bankën e shtetit dhe është i nenëshkrueshem nga "ortaku i vetëm".

N E N I 8

Shoqëria administrohet nga administratori Dashnor Laze, i cili ka kompetenca të plota për drejtimin dhe administrimin e shoqërisë. Përfaqson shoqërinë në lidhje me të tretet si dhe në organet e drejtësisë Gjithashtu ai ka të drejtë të ndermarreveprime në instancat administrative dhe gjyqësore. Dashnor Laze pranon detyrën e administratorit.

N E N I 9

Punësimi i personave të tretë në shoqëri do të bëhet në

kontratës individuale të punës dhe do të zbatohet legjislatiioni shqiptar i punës për të gjitha problemet që nuk parashikohen në kontratë.

N E N I 10

Viti financiar mbyllet më 31 dhjetor të çdo viti.

Ne mbylljet financiare administratori ndjek hartimin e llogarise vjetore në pajtim me dispozitat ligjore. Ortaku i vetëm administrtor miraton bilancin në se është i nevojshëm pas raportit të ekspertit kontabel, brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

N E N I 11

Ortaku i vetëm gëzon të drejten për të hequr e fondeve të nevojshme të kapitalit themeltar nga banka shqiptare, duke depozituar firmën si firmë e parë pranë asaj banke.

N E N I 12

Shpenzimet e nevojshme deri në themelimin e shoqërise janë në ngarkim të shoqërise, e cila me krijimin e saj merr përsipër detyrimin.

N E N I 13

Për mosmarrveshjet që mund të lindin midis paleve brenda dhe jashtë shoqërise, me persona fizike e juridike etj. zgjidhen me mirkuptim në të kundërtën kur ajo nuk arrihet, zgjidhen nga Gjykata kompetente shqiptare.

N E N I 14

Për sa nuk është shprehur në këtë akt themelimi, shoqëria i referonhet çdo ligji të veçantë përkatës që është në fuqi.

N E N I 15

Ky akt themelimi hartohet në tre kopje për tu dorëzuar në organet kompetente, njëra prej të cilave mbetet pjesë e dokumentacionit të shoqërise.

T H E M E L U E S I

Sarandë më 7.2.1995

(Dashnor Laze)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE SARANDE

Nr. 785 rep.

V E R T E T I M

Sot më datën 7.2.1995, para meje noterit Thoma Zaro, u paraqit personalisht kerkuesi Dashnor Laze, biri i Hametit, di.1961, bames ne lagjen 4 Sarandë, i njohur prej meje noterit, i cili deklaroi se me vullnetin e tij të lire dhe të pa vesuar ka redaktuar aktin themelimit të shoqërise dhe është nënshkruar prej tij. Unë noterit i vë re të njohurit dhe nënshkrimin.

NOTERT

(Thoma Zaro)

[Signature]



S T A T U T

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR



(SH.P.K) ORTAK I VETËM.

Në bazë të ligjit 7512 datë 10.8.1991. "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë, veprimtarisë private të pavarur dhe privatizimit" si dhe ligjit 7638 datë 19.11.1992. "Për shoqëritë tregëtare", shtetasi shqipëtar Dashnor Laze, me banim në qytetin e Sarandës, vendosi të ushtrojë aktivitetin privat si "Ortak i vetëm", me seli në lagjen Nr 4 pallati 36 Sarandë me kushtet që vijojnë:

DISPOZITA THEMELORE
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

N E N I 1

F O R M A

Nga Dashnor Laze është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në pajtim me legjislacionin shqipëtar në fuqi dhe me dispozitat e këtij statuti.

N E N I 2

S E L I A

Selia e shoqërisë është në lagjen Nr 4 pallati 36 Sarandë. Shoqëria mund të zhvillojë veprimtari private në të gjithë territorin e Republikës të Shqipërisë. Transferimin e selisë në një adresë tjetër tër bëhet me miratimin e "Ortakut të vetëm".

N E N I 3

E M Ë R T I M I

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.) "Ortak i vetëm" është emërtuar "A 91".

N E N I 4

K O H Ë Z G J A T J A

Shoqëria ka një kohëzgjatje mbi 10 vjet. Ajo mund të priset ose të riorganizohet në çdo kohë me miratim të ortakut të vetëm.

N E N I 5

Shoqëria fiton personalitet juridik që nga koha e regjistrimit të saj në gjykatë në regjistrin tregëtar.

N E N I 6

O B J E K T I

Objekti i veprimtarisë të shoqërisë është:
-Veprimtari në fushën e ndërtimeve dhe montimeve elektrike
-Veprimtari tregëtimi të materialeve elektrike, me pakicë e shumicë.

N E N I 7

K A P I T A L I S H O Q Ë R I S Ë

Për fillimin e veprimtarisë ekonomike financiare shoqëria disponon një kapital fillestar në vlerën 100.000 lekë.

N E N I 8

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet sipas rritjes së veprimtarisë ekonomike të saj. Fondet monetare do të sigurohen nëpërmjet veprimtarisë ekonomike të përcaktuar në nenin 4 të këtij statuti.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI, MARRËDHËNIET EKONOMIKE TË SHOQËRISË

N E N I 9

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "A 91" SH.P.K. "Ortaku i vetëm" do të ketë si administrator Dashnor Laze, i cili ka pushtet të plotë për drejtimin e shoqërisë dhe ka të drejt të kryej të gjitha veprimet që i gjykon si të arsyeshme për arritjen e objektivave të shoqërisë, me përjashtim të atyre që ligji ja rezervon "Ortakut të vetëm".

N E N I 10

Shoqëria administrohet nga administratori Dashnor Laze, i cili vendos:

- Miratimin e statutit të shoqërisë.
- Miratimin e programit ekonomik të shoqërisë.
- Ndarjen dhe përdorimin e fondeve dhe mbulimin e humbjeve.
- Miraton llogaritë në se është e nevojshme për raporte të ekspertit kontabël të autorizuar, brënda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- Ortaku i vetëm mund ti delegojë kompetencat e veta. Vendimi i tij evidencohet në një regjistër.
- Shndërrimin e shoqërisë.
- Ndërprerjen e veprimtarisë së shoqërisë.
- Marrëdhëniet e puësimit brënda shoqërisë e të tjera.
- Vendimet e marra nga administratori, "Ortaku i vetëm" evidencohen në një regjistër të veçantë.

N E N I 11

Për sigurimin dhe funksionimin normal të shoqërisë (ajo) shoqëria mund të lidhë kontrata me sektorë të tjerë shtetërorë, drejt për drejt në tregun e lirë si dhe me persona juridikë e fizikë, vendas e të huaj sipas legjislacionit në fuqi për import-eksport.

N E N I 12

Në veprimet kontabël shoqëria përfaqësohet nga administratori Dashnor Laze, ose persona të tjerë të autorizuar prej tij.

N

N E N I 13

Në bazë të rregulloreve të përcaktuara nga ministria e Financave,



shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, konfikat e derdhjes së tij, sigurimet shoqërore e të tjera.

N E N I 14

Për pasqyrimin e aktivitetit të shoqërisë, administratori i saj ose persona të tjerë të autorizuar prej tij, janë të detyruar të mbajnë dokumentacionin e rregullt financiar në regjistër përkatës, sipas ligjit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

N E N I 15

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të çelë llogarinë përkatëse, pranë bankave të vendit dhe të huaja në Shqipëri dhe të kryej veprimet dhe likuidimet ndërrnjet tyre.

N E N I 16

Administratori i shoqërisë është i detyruar të paraqesë bilancin vjetor së bashku me deklaratën e të ardhurave, të humbjeve dhe fitimeve dhe të depozitohet në organin financiar të juridiksionit që ushtron veprimtari të shoqëria.

N E N I 17

Për ushtrimin e veprimtari të saj ekonomike, shoqëria ka të drejtë të vetëfinancohet me lekë ose me valutë të huaj.

N E N I 18

Shoqëria mund të marrë kredi nga bankat e Shqipërisë ose nga bankat e huaja shtetërore ose private, vendase e të huaja. Shkëmbimi i monedhës shqipëtare me monedhë të huaj dhe anasjelltas, shoqëria mund ta bëjë në përputhje me kursin e caktuar nga banka e shtetit shqiptar ose në tregun e lirë privat të valutës.

N E N I 19

Shoqëria ka të drejtë të transferojë jashtë shtetit shqitar pjesën e saj të fitimit dhe kapitalin. Për aktivitetin administrativ shoqëria duhet të pajiset me vulën e saj.

N E N I 20

Administratori i shoqërisë, ose persona të tjerë të autorizuar prej tij, kanë të drejtë të përfaqësojnë në organet gjtqësore etj.

MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT

N E N I 21

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të përcaktojë numurin e anëtarëve të shoqërisë. Marrëdhëniet e punësimit brenda shoqërisë bëhen sipas kontratës që lidhet lirisht midis palëve. Për çështjet që nuk parashikohen në kontratë, zbatohen dispozitat e kodit të punës në Republikën e Shqipërisë dhe ligjet për marrëdhëniet e punës.

N E N I 22

Marrja në punë bëhet me regjistrimin e punonjësve në librin e punës si dhe duke njoftuar organet e punësimit të juridiksionit ku



ushtron veprimtarinë shoqëria. Të punësuarit brenda shoqërisë janë të detyruar të respektojnë disiplinën e punës, orarin e etj. Ata mbajnë përgjegjësi për thyerjet e disiplinës si dhe për shkaktojnë pasurisë së shoqërisë dhe ndaj tyre zbatohen dispozitat ligjore që janë në fuqi në Republikën E Shqipërisë.

N E N I 23

Ndryshimi i ve drit të punës brenda shoqërisë bëhet me urdhër me shkrim të administratorit të shoqërisë. Largimi përgjithmonë i punonjësit nga shoqëria, bëhet me urdhër me shkrim të administratorit të shoqërisë, mbasi të ketë shlyer detyrimet materiale e monetare.

B I L A N C I dhe të A R D H U R A T

N E N I 24

Të ardhurat e veprimtarisë private të shoqërisë, sigurohen sipas çmimeve që i cakton vetë shoqëria. Çmimet dhe tarifatat do të caktohen sipas kërkesës dhe ofertës.

N E N I 25

Të ardhurat neto krijohen nga veçimi i fondit të akumulimit, shlyerjes të detyrimit fiskal, sigurimeve shoqërore e të tjera.

S H P È R N D A R J A e S H O Q È R I S È

N E N I 26

Shoqëria mund të shpërbëhet në çdo kohë kur veprimtaria e saj ekonomike financiare falimenton. Në rastin e pushimit të veprimtarisë të saj ekonomike bëhet likuidimi përfundimtar i pasurisë së shoqërisë.

N E N I 27

Kur pushon veprimtaria e shoqërisë, mbasi shlyhen detyrimet fiskale, sigurimet shoqërore etj. kapitali i mbetur i kalon në pronësi themeluesit të shoqërisë Dashnor Laze.

D I S P O Z I T A të F U N D I T

N E N I 28

Mosmarrëveshjet midis palëve brenda shoqërisë dhe jashtë saj, në marrëdhëniet me personat fizikë dhe juridik etj. zgjidhen me mirëkuptim dhe kur kjo nuk arrihet, zgjidhet nga gjykata kompetente shqiptare.

N E N I 29

Për sa nuk është shprehur në këtë statut, i referohet çdo ligji të veçantë përkatës në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

N E N I 30

Ky statut hartohet në tre kopje për tu dorëzuar në organet kompetente. Një kopje e të cilit mbetet pjesë e dokumentacionit të shoqërisë "A 91"SH.P.K. me seli në Sarandë.

Sarandë më 7.2.1995

T H E M E L U E S I
(Dashnor Laze)